



Group for Legal
and Political
Studies



KOSOVO LAW INSTITUTE
INSTITUTI I KOSOVES PER DREJTESI
KOSOVSKI INSTITUT PRAVDE

FOL

Integriteti i procesit të përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit

(Raport i monitorimit dhe vlerësimit të procesit të përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit)



Prishtinë, Mars 2022

**Autorë: Instituti i Kosovës për Drejtësi/Grupi për Studime Juridike dhe
Politike/Lëvizja Fol**

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Mars, 2022

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

| | | |
|-------|-----------------------------------------------|----|
| I. | Hyrje | 4 |
| II. | Transparenca e procesit | 4 |
| III. | Metodologjia e monitorimit | 4 |
| IV. | Dizajnimi jo adekuat i procesit..... | 5 |
| V. | Konfirmimi i kandidaturave | 5 |
| VI. | Rangimi i kandidatëve sipas koalicionit..... | 6 |
| i. | Shqipdon Fazliu..... | 6 |
| ii. | Armend Hamiti..... | 8 |
| iii. | Blerim Isufaj | 10 |
| iv. | Kujtim Munishi..... | 12 |
| v. | Lulzim Sylejmani | 15 |
| VII. | Vlerësimi i panelit vlerësues | 16 |
| VIII. | Trajtimi i pabarabartë i kandidatëve | 16 |
| IX. | Vlerësimi i integritetit të kandidatëve | 16 |
| X. | Rekomandime | 17 |

I. Hyrje

Organizatat Jo-Qeveritare Instituti i Kosovës për Drejtësi, Grupi për Studime Juridike dhe Politike dhe Lëvizja FOL (*Tutje*: Koalicioni), si organizata të specializuara në fushën e sundimit të ligjit në Kosovë dhe me përvojë të gjatë në monitorimin e sistemit prokurorial të Kosovës, janë pajtuar që së bashku të bëjnë monitorimin dhe vlerësimin e procesit të përzgjedhjes dhe emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit.

Monitorimin dhe vlerësimin në fjalë koalicioni e ka bazuar në katër shtylla:

- 1) Vlerësimi i strukturës së procesit për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit;
- 2) Analizimin e Koncept Dokumenteve të kandidatëve;
- 3) Monitorimin e intervistave; dhe
- 4) Qasjen e panelit vlerësues ndaj kandidatëve.

II. Transparenca e procesit

Për dallim nga rastet e kaluara, koalicioni ka pasur mundësi të bëjë një monitorim të plotë dhe objektiv, për faktin se KPK ka treguar një shkallë të lartë të transparencës përkitazi me këtë proces. Përkatësisht, KPK ka publikuar të gjitha Koncept Dokumentet e kandidatëve, ka lejuar monitorimin direkt të intervistave si dhe ka transmetuar intervistat në televizionin publik. Kjo qasje e KPK është një praktikë pozitive, e pashembullt deri më tani në këtë institucion, ku i jep mundësi publikut, mediave dhe OJQ-ve për të përcjellë drejt për së drejti dhe në kohë reale gjithë procesin për përzgjedhjen dhe emërimin e një prej pozitave kryesore në sistemin prokurorial të Kosovës.

III. Metodologjia e monitorimit

Për të zhvilluar procesin e monitorimit dhe vlerësimit, koalicioni është bazuar në legjislacionin në fuqi. Metodologjia e koalicionit për monitorimin e këtij procesi është bazuar në Udhëzuesin për nenet 13 dhe 14 të Rregullores për Emërimin e Kryeprokurorit dhe Kryeprokurorëve (Udhëzuesi), të miratuar nga vet KPK.

Për të siguruar një proces objektiv, të drejtë dhe transparent i cili trajton të gjithë kandidatët në mënyrë të barabartë, Paneli Vlerësues do të duhej të poentonte secilin kandidat në bazë të këtyre kriterëve:

- 1) Koncept Dokumenti deri 30 pikë;
- 2) Integriteti deri 20 pikë;
- 3) Aftësitë udhëheqëse dhe menaxheriale deri në 30 pikë; dhe
- 4) Njohuritë dhe përvoja teknike deri në 20 pikë.

Edhe përkundër faktit se ky Udhëzues ka përcaktuar parimet dhe procedurën që Paneli Vlerësues do të duhej të ndiqte për të siguruar një proces objektiv, transparent, jo-diskriminues dhe gjithëpërfshirës, të bazuar në merita, i njëjti nuk ka gjetur zbatim.

IV. Dizajnimi jo adekuat i procesit

Sipas koalicionit, përkundër se Kushtetuta dhe ligjet bazike promovojnë një proces të pavarur, të drejtë dhe të paanshëm që garanton meritokracinë, këtë frymë e pengon si udhëzuesi ashtu edhe formulari i Koncept Dokumentit për kandidatët për Kryeprokuror të Shtetit.

Sa i përket udhëzuesit, i njëjti është i orientur më shumë drejt vlerësimit të njohurive teorike se sa i bazuar në shkathtësi dhe aftësi të cilat ndërlidhen me pozitën e kryeprokurorit.

Shumica e pyetjeve në formularin e koncept dokumentit për kryeprokuror të shtetit janë të bazuara në ligjet e shfuqizuara dhe kohën kur Kryeprokurori i Shtetit njëkohësisht ishte edhe Kryesues i KPK. Shumë pyetje në këtë formular ndërlidhen me proceset që janë kompetencë e KPK dhe jo Kryeprokurorit të Shtetit. Në intervistat me gojë, shumica e kandidatëve nuk kanë qenë në gjendje që të bëjnë dallimin në mes të kompetencave bazë të Kryeprokurorit të Shtetit dhe atyre të KPK.

V. Konfirmimi i kandidaturave

Sa i përket procesit i cili është objekt i monitorimit dhe vlerësimit të koalicionit, KPK në pajtim me Ligjin dhe legjislacionin sekondar, brenda afatit ligjor kishte shpallur konkursin për Kryeprokuror të Shtetit.

Në këtë garë kanë konkuruar gjashtë (6) kandidatë, përkatësisht z. Armend Hamiti, z. Blerim Isufaj, z. Kujtim Munishi, z. Shqipdon Fazliu dhe z. Lulzim Sylejmani. Po ashtu, në këtë garë kishte aplikuar edhe prokurori z. Arben Ismajli, por që i njëjti është tërhequr nga kjo garë pas opinionit të Agjencisë kundër Korrupsion që konstatonte se emërimi i tij në pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit do të përbënte shkelje të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

AKK më 4 mars 2022 ka nxjerrë opinion, duke konstatuar se emërimi eventual i ish-anëtarëve të KPK-së në pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit, pa kaluar afati prej dy (2) viteve nga përfundimi i mandatit të anëtarit të KPK-së, bie ndesh me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik. Në këtë rast, sipas AKK-së, kandidati z. Arben Ismajli, nëse do të emërohej si Kryeprokuror i Shtetit, do të përbënte konflikt të interesit.

Situatë të njëjtë me z. Ismajli, kishte pasur edhe kandidati z. Blerim Isufaj me rastin e emërimit të tij në krye të PSRK-së në fund të vitit 2019. Por, këtë situatë, AKK nuk e ka trajtuar me arsyetimin se kanë kaluar dy (2) vite nga emërimi i tij në këtë pozitë. Me këtë rast, është shumë e rëndësishme të sqarohet se situata e z. Isufaj është e njëjta me atë të z. Ismajli. Por, dështimi i AKK-së për të trajtuar rastin e z. Isufaj brenda afateve ligjore i ka krijuar të njëjtit mundësi të emërohet në pozitën e Kryeprokurorit të PSRK-së, por jo vetëm. Kjo situatë, i ka krijuar mundësi atij që përtej PSRK-së, të pretendoj edhe kreun e Prokurorit të Shtetit.

Edhe përkundër opinionit të AKK-së për situatën e z. Ismajli dhe vëmendjes që ky opinion ka marrë në publik, KPK nuk ka marrë asnjë veprim për të trajtuar ndikimin që ky opinion i

agjencisë do të duhej të kishte në raport me emërimin e z. Isufaj në krye të PSRK, duke qenë aso kohe në konflikt të interesit.

Përderisa KPK dhe z. Isufaj në heshtje kanë injoruar konfliktin e interesit në përzgjedhjen e këtij të fundit në krye të PSRK-së, duke cenuar integritetin e vet procesit për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit, kandidati z. Arben Ismajli ka kërkuar të sqarohet situata potenciale e konfliktit të interesit dhe pas pranimit të opinionit të Agjencisë, i njëjti ka dëshmuar integritet duke u tërhequr nga gara. Fatkeqësisht, një veprim të tillë nuk e kemi parë nga z. Isufaj dhe as nga KPK edhe pse gjendja faktike ka qenë identike.

VI. Rangimi i kandidatëve sipas koalicionit

Në bazë të vlerësimit të Koalicionit, duke u bazuar në vlerësimin e koncept dokumenteve dhe vlerësimin e intervistave të kandidatëve, koalicioni konsideron se asnjëri kandidat nuk ka arritur të dëshmojë shkathtësi, njohuri dhe aftësi për pozitën që kanë aplikuar. Sikurse, në bazë të asaj që kanë prezantuar, në bazë të vlerësimit të përgjithshëm, koalicioni rangon kandidatët në këtë mënyrë: 1) Shqipdon Fazliu, 2) Armend Hamiti, 3) Blerim Isufaj, 4) Kujtim Munishi dhe 5) Lulzim Sylejmani.

Sa i përket vetëm Koncept Dokumentit, Koalicioni ka ranguar kandidatët në këtë mënyrë: 1) Armend Hamiti, 2) Shqipdon Fazliu dhe tre (3) të tjerët rangohen në pozitën e njejtë.

Ndërsa, sa i përket vetëm intervistës, koalicioni ka ranguar kandidatët në këtë mënyrë: 1) Shqipdon Fazliu, 2) Armend Hamiti, 3) Blerim Isufaj, 4) Lulzim Sylejmani dhe 5) Kujtim Munishi.

i. Shqipdon Fazliu

1. Koncept dokumenti

a) Analiza e gjendjes aktuale

Kandidati z. Shqipdon Fazliu në këtë pjesë më tepër flet për cilësitë e tij, të cilat e bëjnë atë të denjë për Prokurorin e Shtetit, se sa që flet për gjendjen aktuale të sistemit prokurorial. Mbi mangësitë e sistemit prokurorial, z. Fazliu flet në dy (2) paragrafa. Liston shumë probleme me të cilat ballafaqohet sistemi prokurorial, por këtë listim të problemeve nuk e shoqëron me argumentim të këtyre problemeve dhe me një qasje analitike. Në asnjë prej katër (4) pyetjeve që sipas udhëzuesit kërkojnë përgjigje në këtë pjesë, z. Fazliu në koncept dokumentin e tij nuk jep përgjigje të plotë.

b) Vizioni për të përmirësuar punën e Prokurorisë

Sipas udhëzuesit, kërkohet që në këtë pjesë të ipet përgjigje në gjithsej tri (3) pyetje relevante. Në hyrje të kësaj pjese, z. Fazliu paraqet një vizion eksplicit, se ku e sheh ai Prokurorin e Shtetit me të në krye. Pas dy (2) paragrafëve që e përcakton këtë vizion, z. Fazliu paraqet si sfidë qasjen e re që ai do ta ndjekë. Mënyra e zgjidhjes së kësaj sfide, sipas z. Fazliu, do të jetë se

“posa prokurorët të mësojnë për përfitimet që sjell mënyra e re e qasjes ndaj luftimit të krimit, besoj se ajo do të përqafohet nga të gjithë dhe sfidat do të zbuten”. Po ashtu, z. Fazliu thotë se sfidat do ti tejkaloj bashkarisht me KPK përmes llogaridhënies dhe vlerësimit të performancës.

Përballë besimeve të z. Fazliu se sistemi do të pësoj avancim, i njëjti nuk tregon hapa konkret përmes identifikimit të objektivave afatmesme dhe afatgjata, ashtu siç kërkohet me udhëzues.

c) Vizioni për të menaxhuar stafin dhe sistemin prokurorial

Në këtë pjesë, si aspekt pozitiv cilësohet se z. Fazliu tregon mënyrën e ndërveprimit me kolegë në të kaluarën, si një cilësi të tij në kontekst të ndërveprimit me kolegë. Po ashtu, sa i përket stafit, z. Fazliu planifikon që të ngrisë cilësinë e stafit përmes inkuadrimit më të madh të stafit në raste, ku specifikon edhe natyrat e procedurave ku do të përfshiheshin të njëjtit.

Aspekti më pozitiv i z. Fazliu në këtë pjesë është metodologjia e ngritjes së llogaridhënies së prokurorëve përmes kryeprokurorëve. Sipas tij, për dështimet e prokurorëve, duhet të merren në përgjegjësi edhe kryeprokurorët, të cilët duhet të sinjalizojnë shkeljet e prokurorëve.

Në këtë pjesë, z. Fazliu thotë se do të shmangen rastet kur krejtësisht pa nevojë palët udhëzohen në kontest civil. Nisur nga fakti se ky udhëzim bëhet nga Gjykata dhe se kërkesa pasurore juridike nuk parashtrohet dhe argumentohet nga ana e Prokurorit të Shtetit, kjo çështje vlerësohet si e pamundur që të zbatohet nga ana e Kryeprokurorit të Shtetit.

d) Vizioni për të përmirësuar integritetin dhe llogaridhënien e sistemit dhe besueshmërinë e publikut

Kjo është pjesa më e fuqishme e Koncept Dokumentit të z. Fazliu. Në këtë pjesë, z. Fazliu liston disa çështje, të cilat i sqaron si për nga motivi për të trajtuar këto çështje, mënyrën e trajtimit si dhe impaktin që këto çështje do ta kishin në sistemin prokurorial. Këtu, z. Fazliu përmend çështje të shumta, si aplikimi i procedurave alternative, rritja e bashkëpunimit me policinë, ngritja e cilësisë së hetimeve, ngritja e cilësisë së përfaqësimit të rasteve në gjykatë, ngritja e cilësisë së ankesave, ngritja e numrit të kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë, unifikimi i veprimeve, konfiskimi i pasurisë së përfituar përmes veprës penale, prioritizimi i rasteve etj.

Po ashtu, përpos që në kuadër të çështjeve specifike z. Fazliu përmend ndikimin e veprimeve të caktuara në ngritjen e besueshmërisë së publikut, i njëjti përcakton edhe veprime konkrete të cilat do të ngrisin besimin e publikut në sistemin prokurorial. Ndër to, janë edhe takimet vjetore me qytetarë.

Në pjesën e komunikimit me media, z. Fazliu përgjigjet sipërfaqësisht dhe nuk paraqet një strategji të detajuar se si do të ngritej bashkëpunimi me media si dhe nuk paraqet ndonjë strategji të qartë për ngritjen e efikasitetit të komunikimit të sistemit prokurorial me mediat, i cili efikasitet më së shumti pengohet nga centralizimi i informacionit prokurorial në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.

2) Intervista

Në hyrje të intervistës së tij, z. Fazliu thotë se motivi i tij për të aplikuar për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit është përvoja e tij dhe qasja e tij kritike që ka pasur në të kaluarën, duke thënë se me ardhjen e tij në krye të Prokurorit të Shtetit do të kemi një prokurori tjetër. Sa i përket gjendjes në sistemin prokurorial, z. Fazliu me të drejtë elaboron se sistemi prokurorial ka avancuar në disa fusha të luftimit të kriminalitetit, por se ka ngecur në luftimin e korrupsionit të profilit të lartë, krimin ekonomik, pastrimit të parave etj.

Gjatë intervistës së tij, z. Fazliu elaboron edhe çështjet të cilat i ka ngritur në koncept dokument, siç është bashkëpunimi me policinë, cilësia e hetimeve etj. Po ashtu, edhe gjatë intervistës, z. Fazliu në mënyrë bindëse, logjike dhe analitike flet për ngritjen e llogaridhënies së prokurorëve përmes mbajtjes përgjegjës së kryeprokurorëve. Po ashtu, edhe ngritjen e transparencën, z. Fazliu e elaboron përmes veprimeve konkrete që sipas tij duhet ndërmarrë sistemi prokurorial.

z. Fazliu tregon edhe hapa konkret për ngritjen e efikasitetit dhe strukturimit të punës në PSRK, për të cilën prokurori, z. Fazliu me të drejtë vlerëson se duhet të jetë e fokusuar në rastet më të mëdha në vend.

Gjatë intervistës së tij, z. Fazliu e njeh rëndësinë e zbatimit të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe akteve përkatëse për vlerësim të performancës. Por, përballë asaj që z. Fazliu thotë se këto akte duhet të zbatohen mjaftueshëm, i njëjti nuk flet për pengesat dhe sfidat e zbatimit të tyre apo hapat konkret që do të ndërmarrë për të ngritur zbatimit e këtyre akteve.

Aspekt i mangët i intervistës së z. Fazliu është mos trajtimi adekuat i hapave që duhet ndërmarrë për ngritjen e besimit të publikut në sistemin prokurorial, ku z. Fazliu përmend vetëm unifikimin e praktikës, të cilin unifikim e elaboron përmes shembujve të ndryshëm.

Përmes përcaktimit të dobisë pasurore të të pandehurit, z. Fazliu thotë se, ndër të tjera, do të ulet numri i rasteve të cilat udhëzohen në kontest civil. Përkundër që përcaktimi i dobisë pasurore është i rëndësishëm dhe ka një relevancë në këtë drejtim, kjo pjesë nuk duket të jetë një premtim i zbatueshëm nga ana e Prokurorit të Shtetit, për shkak se, siç u tha, për këtë vendos gjykata dhe prokurori i shtetit nuk përfaqëson kërkesën pasurore juridike.

ii. Armend Hamiti

1. Koncept dokumenti

a) Analiza e gjendjes aktuale

Për dallim nga kundër kandidatët e tjerë, Hamiti në Koncept dokumentin e tij ka dhënë elemente dhe analizë të detajuar sa i përket gjendjes aktuale në sistemin prokurorial, me theks të veçantë në Institucionin e Prokurorit të Shtetit. Këtu ai i liston edhe disa nga mangësitë që e përcjellin punën e PSH-së të cilat janë theksuar edhe nga raportet e monitorimit si: mungesa e planifikimit adekuat, mungesa e rezultateve në luftën kundër krimin të organizuar dhe

korupsionit, mungesa e konfiskimit të pasurisë dhe aplikimi i procedurave alternative, ngitja e aktakuzave ndaj personave të vdekur, humbja e besimit qytetar në PSH etj.

b) Vizioni për të përmirësuar punën e Prokurorisë

Referuar Koncept dokumentit të kandidatit Hamiti, i njëjti këtu ka përmendur objektiva konkrete lidhur me trajtimin e e mangësive të adresuara. Këtu bëjnë pjesë, rezultatet konkrete në punën e PSRK-së dhe Prokurorive Themelore në luftën kundër krimit të organizuar, korupsionit, duke zbatuar në përpikëri bazën ligjore dhe kompetencat që i përcakton ligji. Po ashtu, përmend rëndësinë e trajtimit të rasteve mediatike në çdo moment kur ka dyshim për kryerjen e veprave penale, me theks të veçantë në rastet e korupsionit. Hamiti thekson edhe vizionin e tij për PSH transparent dhe llogaridhënës, e fuqizimin e mbikëqyrjes në rastet e konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme dhe fuqizimin e punës së Departamentit për të mitur me psikolog.

c) Vizioni për të menaxhuar stafin dhe sistemin prokurorial

Në këtë pjesë, Hamiti thekson çështjen e kompetencës së rekrutimit, avancimit, transferimit, disiplinimit dhe masave të tjera nga ana e Sekretariatit të KPK-së, gjë të cilën e ngatërrojnë si kompetencë një pjesë e kandidatëve të tjerë. Për më tepër, Hamiti shton se si anëtar i KPK-së, do të jetë proaktiv në propozimin e politikave dhe strategjive me të cilat promovohen interesat e stafit administrativ, përfshirë këtu llogaridhënien dhe përgjegjësinë e tyre.

d) Vizioni për të përmirësuar integritetin dhe llogaridhënien e sistemit dhe besueshmërinë e publikut

Lidhur me këtë çështje, Hamiti thekson se në cilësinë e KPSH-së dhe anëtarit të KPK-së do të sigurohet që Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore për Prokurorë dhe Kodet e Etikës së sjelljes së prokurorëve dhe stafit të jenë kushtetuta e tyre. Me këtë rast, ai zotohet së çdo kush që bie në kundërshtim me këto dispozita do të shqiptohen masa disiplinore pavarësisht funksionit të tyre në sistemin prokurorial.

2) Intervista

Intervista e Hamitit para Komisionit Vlerësues në të shumtën e kohës është orientuar në Koncept Dokumentin e tij, me ç'rast është vërejtur se i njëjti nuk ka dhënë përgjigje konkrete në raport me ato të paraqitura në këtë dokument. Kësisoj, Hamiti nuk ishte në gjendje që të listonte në përpikëri të gjitha mangësitë, sfidat dhe objektivat e tij gjatë intervistës.

Po ashtu, gjatë monitorimit të intervistës së Hamitit kemi vërejtur që nga ana e Komisionit nuk janë bërë mjaftueshëm pyetje sa i përket pjesës së aftësive menaxhuese dhe mbi rëndësinë e rolit të KPSH-së, dhe aplikimit të IT-së në punën e sistemit prokurorial.

Po ashtu, vlerësojmë se në pyetjet rreth integritetit, Hamiti ka dhënë më shumë detaje sesa që duhet sa i përket lajmit të publikuar në Paparaci.com, e si duket një gjë e tillë u imponua edhe nga ana e nën pyetjeve të bëra nga anëtarët e Panelit.

Gjatë intervistës ka qenë me i qartë sa i përket rritjes së bashkëpunimit me akterët ndërkombëtare, shoqërinë civile, dhe institucionet e tjera, si pjesë e vizionit të tij në krye të PSH-së.

iii. Blerim Isufaj

1. Koncept dokumenti

a) Analiza e gjendjes aktuale

Disa prej kërkesa të udhëzuesit për këtë pjesë, Isufaj në Koncept Dokument i ka trajtuar vetëm shkarazi dhe ka listuar vetëm informata të përgjithshme, pa një analizë të detajuar që do të krijonte bindjen se i njëjti i njeh problemet, siç kërkohet nga udhëzuesi. Tek mangësitë, Isufaj ka përmendur dënimet e pakta dhe numrin e ulët të konfiskimeve, por se i ka përmendur si faktorë që ndikojnë në uljen e besimit të publikut në sistemin prokurorial dhe jo si mangësi në vetvete. Isufaj, në Koncept Dokumentin e tij, nuk e vlerëson fare situatën aktuale të ZKSh si dhe i njëjti nuk vlerëson nëse strategjitë aktuale të sistemit të drejtësisë adresojnë nevojat e prokurorisë.

b) Vizioni për të përmirësuar punën e Prokurorisë

Sipas Udhëzuesit, kandidati kërkohet që të përcaktojë vizionin e tij për përmirësimin e punës. Në këtë pjesë, z. Isufaj flet për fokusin që do ta ketë në luftimin e krimit të organizuar, krimit financiar, terrorizmit, krimeve të luftës, korrupsionit etj. duke mos përmendur faktin se luftimi i këtyre formave të kriminalitetit nuk është kompetencë e prokurorisë për të cilën z. Isufaj aplikon, por është kompetencë e prokurorisë që z. Isufaj aktualisht udhëheq. Në këtë pjesë, Isufaj ngatërron konsiderueshëm kompetencat edhe në raport me institucionet e tjera. Tek veprimet që z. Isufaj planifikon të ndërmarrë si Kryeprokuror i Shtetit, është edhe “Rishikimi i kornizës ligjore dhe nënligjore në ridefinim të kompetencave në mes të Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial për fushën e administrimit”, përkundër se rishikimi i kornizës ligjore është kompetencë e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Po ashtu, në Koncept Dokument, z. Isufaj thotë se do të hartohet edhe Koncept Dokumenti për Ligjin për Statusin e Prokurorëve, kompetencë kjo e Qeverisë së Kosovës. Përmes Ligjit për Statusin e Prokurorëve, Isufaj thotë se prokurorëve duhet tu ofrohet garanci ligjore për punën e tyre në rastet e padive civile. Këtë pjesë, z. Isufaj e përmend si vizion për të ardhmen, përkundër se ligji që i mbron prokurorët nga paditë civile për veprimet, vendimet dhe mendimet në kuadër të fushë veprimtarisë së vet është në fuqi . Në këtë pjesë, z. Isufaj liston gjithsej 12 sfida, por se nuk tregon mënyrën e zgjidhjes së secilës prej tyre.

c) Vizioni për të menaxhuar stafin dhe sistemin prokurorial

Në këtë pjesë, Isufaj thotë se çdo punë e mirë do të motivohet, derisa puna jo e mirë do të jetë pikënisje për mbajtje përgjegjës. E quditshme është arsyeja se pse z. Isufaj do ta bëjë këtë: Arsyeja kryesore dhe bazë për të ndjekur këtë standard është vlerat që kanë për mua të drejtat dhe liritë e qytetarëve dhe siguria që kërkohet për mbrojtjen e tyre nga prokuroria. Këtu, nuk është e qartë se cilën të drejtë të njeriut apo liri të qytetarëve e prek motivimi/ndëshkimi për

punën e mirë dhe jo të mirë. Po ashtu, në këtë pjesë, z. Isufaj thotë se “Mbikëqyrja e prokurorëve dhe stafit do të bëhet nga aspekti i motivimit pozitiv për rezultate sa më të larta, por vetëm duke respektuar vlerat e mbrojtura nga Kushtetuta dhe Ligji”. Nuk është e qartë këtu se për cilat vlera kushtetuese bëhet fjalë këtu, nisur nga vlerat e listuara nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

d) Vizioni për të përmirësuar integritetin dhe llogaridhënien e sistemit dhe besueshmërinë e publikut

Në këtë pjesë, z. Isufaj nuk jep një plan të detajuar, të ndërtuar mbi skanimin e gjendjes së integritetit dhe llogaridhënies në sistemin prokurorial, përmes të cilit tregon qartësisht mënyrën se si do të avancojë integritetin dhe llogaridhënien brenda sistemit të drejtësisë. Në këtë pjesë, ka edhe elemente të tjera të cilat nuk ndërlidhen me integritetin dhe llogaridhënien e sistemit prokurorial.

2) Intervista

Pjesa qendrore e intervistës së z. Blerim Isufaj ka pasur të bëjë me Koncept Dokumentin e dorëzuar nga ai.

Për ngritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, në disa raste, z. Isufaj tregon se si duhet ta shoh publiku drejtësinë dhe nuk tregon se cila do të jetë strategjia për ngritjen e besimit të publikut në sistemin prokurorial. Gjatë prezantimit të tij, z. Isufaj pa një qasje analitike kalon nga një temë në tjetrën, përmend në mënyrë të përgjithshme pavarësinë e Prokurorit të Shtetit, standardet ndërkombëtare, pa specifikuar se për cilat standarde ndërkombëtare bëhet fjalë, etj. duke mos treguar praktikisht se cili është vizioni i tij për përmirësimin dhe avancimin e punës së Prokurorit të Shtetit.

Gjatë intervistës, me rastin e parashtrimit të pyetjeve mbi integritetin, Paneli Vlerësues nuk e ka pyetur z. Blerim Isufaj mbi disa çështje të cilat janë e kanë vënë në diskutim integritetin e tij, si emërimi në krye të PSRK-së në situatë të konfliktit të interesit, akuzat e ngritura nga ish-prokurori Elez Blakaj për ndërhyrje në rastin e veteranëve, rasti kur kishte ngritur aktakuzën pa aktvendim për fillim të hetimeve e për të cilin fakt ishte rrëzuar aktakuza për trafikim të narkotikëve etj.

Kur pyetet mbi Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Isufaj thotë se nuk ka ndonjë koment për këtë ligj, por se në punën e tij, performanca dhe integriteti do të jenë prioritet. Kur pyetet për kufizimin dhe suspendimin e të drejtave të njeriut, z. Isufaj tregon mos njohuri të thellë mbi këto institute. Fillimisht, z. Isufaj thotë se Kushtetuta e Kosovës i ka të aprovuar të gjitha konventat ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Thotë se të drejtat e njeriut duhet të respektohen maksimalisht, përveç situatave të caktuara, siç janë luftërat apo ndonjë rrezik i madh. Sipas tij, disa të drejta mund të anulohen, por kjo nuk duhet të zgjat ma tepër se sa situata që ekziston. Sipas tij, në situata të tilla, duhet të njoftohet Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës. Tutje, në pyetjet për kufizimin dhe suspendimin e të drejtave të njeriut, z. Isufaj vazhdon të elaboroj nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat

e Njeriut, i cili nen flet për të drejtën për një proces të rregullt. Përmes kësaj përgjigje, z. Isufaj ka demonstruar mungesë të thellë të njohurive në këtë fushë. Fillimisht, Kushtetua e Republikës së Kosovës i ka inkorporuar 9 Konventa ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, por se jo të gjitha konventat e kësaj natyre, siç thotë z. Isufaj. Në përgjigjen e tij, z. Isufaj nuk e trajton fare kufizimin e të drejtave të njeriut apo nuk bënë dallimin në mes të kufizimit dhe suspendimit të të drejtave të njeriut, por flet vetëm për suspendim të të drejtave të njeriut. Sa i përket informimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, kjo nuk aplikohet në rastet e kufizimit të të drejtave të njeriut, por vetëm në rastet e suspendimit apo derogimit të të drejtave të njeriut. Po ashtu, z. Isufaj nuk përmend faktin se ky obligim zbatohet vetëm për shtetet palë të Konventës, që nuk është rasti i Kosovës.

iv. Kujtim Munishi

1. Koncept dokumenti

a) Analiza e gjendjes aktuale

Analiza mbi gjendjen aktuale është konfuze, më të dhëna statistikore të bazuara në sasi pa ofruar ndonjë të dhënë analitike dhe të besueshme. Lidhur me përparësitë e Prokurorit të Shtetit, janë përshkruar kompetenca, veprimtari dhe aktivitete të sistemit prokurorial pa ndonjë analizë adekuate. Në këtë pjesë i kushtohet rëndësi Planit Strategjik 2019-2021, duke përshkruar objektivat e Strategjisë dhe Planin e Veprimit i cili tanimë është i tejkaluar, për të vazhduar me përshkrimin e Draft Strategjisë së KPK për vitet 2022-2024, pa ofruar ndonjë vlerësim apo analizë adekuate lidhur me qëndrimin e kandidatit për të ofruar informacion mbi gjendjen aktuale apo cili është qëndrimi i tij lidhur me këtë Strategji dhe Plan të Veprimit.

Tek pjesa e mangësive të Prokurorit të Shtetit, janë listuar mangësitë në rregullimin e statusit të Prokurorit të Shtetit, pa shtjelluar apo dhënë të paktën një analizë të shkurtë se cilat janë këto probleme apo si ndikon mungesa e statusit të Prokurorit të Shtetit në punën e institucionit të Prokurorit të Shtetit. Po ashtu, si mangësi janë potencuar mangësitë profesionale të stafit administrativ dhe ligjit procedural, pa asnjë analizë përmbajtësore apo shtjellim se si ndikon kjo në funksionimin apo operimin e institucionit të Prokurorit të Shtetit.

b) Vizioni për të përmirësuar punën e Prokurorisë

Në këtë pjesë të koncept dokumentit janë listuar aktivitete, objektiva dhe janë të identifikuar vështirësi të përdorura nga strategjitë apo planet e veprimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit pa një vizion të qartë, shtjellim apo shpjegim se si do të realizohen në praktikë këto aktivitete për të përmirësuar punën e Prokurorit të Shtetit.

c) Vizioni për të menaxhuar stafin dhe sistemin prokurorial

Në këtë pjesë flitet për rishikimin e strukturës organizative të administratës së sistemit prokurorial, edhe përkundër faktit se asnjë dokument strategjik qoftë nga Strategjia e Sundimit të Ligjit apo Planet Strategjike dhe Planet e Veprimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, nuk kanë ardhur në ndonjë konstatim se struktura organizative e administratës së sistemit

prokurorial është çështje problematike. Lidhur me llogaridhënien dhe profesionalizmin e stafit, është përmendur se stafi duhet të respektoj Kushtetutën dhe ligjin, deri të obligimi i stafit për të vepruar sipas “urdhrave” të administratorit dhe obligimi për vlerësim obligativ të performancës, por pa treguar kuartë se si do të menaxhohet stafi në praktikë, cilat janë kompetencat e KPSH në raport me kompetencat e KPK dhe Sekretariatit të KPK.

d) Vizioni për të përmirësuar integritetin dhe llogaridhënien e sistemit dhe besueshmërinë e publikut

Në këtë pjesë janë propozuar aktivitete të cilat dalin jashtë mandatit të KPSH dhe të cilat nuk janë identifikuar si probleme nga Strategjia për Sundimin e Ligjit apo nga vet sistemi prokurorial. Është propozuar fuqizimi i kornizës ligjore dhe strukturës organizative të sistemit prokurorial, avancimi i statusit të prokurorëve dhe stafit mbështetës, forcimi i garancioneve kushtetuese dhe ligjore që fuqizojnë pavarësinë e sistemit prokurorial, dhe masa tjera të cilat dalin jashtë mandatit të KPSH, por që nuk identifikojnë apo nuk ndërlihen me çështjen e integritetit dhe llogaridhënies në sistemin prokurorial.

2) Intervista

Tek pyetja lidhur me motivin pse ka aplikuar për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit, kandidati z. Munishi flet fare pak lidhur me motivin për të kandiduar për këtë pozitë dhe më shumë flet lidhur me vizionin dhe objektivat e tij për fuqizimin e PSRK, Prokurorisë Themelore në Prishtinë, dhe luftimin e korrupsionit dhe veprave penale karakteristike, edhe pse KPSH parimisht nuk ka mandat dhe kompetencë për të realizuar këto premtime.

Në këtë pjesë kandidati flet lidhur me rëndësinë e luftës kundër dhunës në familje dhe rolit të tij proaktiv për të trajtuar këtë fenomen në PTh në Prishtinë, por nuk flet fare për rastin Sebahate Morina e cila ishte viktimë e vrasjen nga dhuna në familje, për të cilin rast Institucioni i Avokatit të Popullit dhe disa OJQ kanë konstatuar shkeljen e së drejtës në jetë ndaj tani të ndjerës Sebahate Morina. Paneli vlerësues fare nuk bën nën pyetje lidhur me këtë rast, i cili ishte rast mediatik, e për të cilin rast ishin organizuar edhe protesta nga organizatat që mbrojnë të drejtat e grave në Kosovë.

Kryesuesi i Panelit në rastin e kandidatit para parashtrimit të pyetjeve, jep vlerësime për kandidatin se ka një përvojë të gjatë në sistem, se udhëheq me Prokurorinë më të madhe në Kosovë.

Kandidati lidhur me gjendjen në sistemin prokurorial konstaton se sistemi prokurorial ka arritur progres të madh dhe këtë e vërtetojnë statistikave dhe raportet ndërkombëtare që e kanë vlerësuar punën e sistemit prokurorial, përkundër se raportet kredibile si raporti i vendin, i nxjerrë nga Komisioni Evropian, e konstatojnë të kundërtën. Ndër mangësitë e sistemit prokurorial kandidati përmend mungesën e imunitetit të prokurorëve të përcaktuar në Kushtetutë, se ndryshimi i ligjeve pengon në punën e Prokurorit të Shtetit, sikurse flet për me projektligjin për KPK dhe përbërjen e re të Këshillit Prokurorial në të ardhmën, përkundër se kjo është një rrethanë që mund të ndodh në të ardhmen dhe nuk lidhet me gjendjen aktuale të KPK. Kandidati

paragjykon anëtarët jo prokurorë të KPK që mund të emërohen në të ardhmen se mund të jenë jo profesional dhe të anshëm.

Lidhur me transparencën dhe llogaridhënien kandidati kryesisht flet lidhur me rëndësinë e bashkëpunimit me median dhe shoqërinë civile, rëndësinë e fitimit të besimit të publikut dhe qytetarëve, por që këtë bashkëpunim nuk e konkretizon me hapa konkret.

Kandidati disa herë nuk ka vëmendjen ndaj Panelit Vlerësues lidhur me pyetjet që i parashtrohen dhe kërkon që pyetjet ti përsëriten.

Kandidati në pyetjen lidhur me ristrukturimin e stafit administrativ, jep përgjigje të pakuptueshme se si do të bëhet ky ristrukturim, duke lënë për të kuptuar se duhet të ndryshohet ligji mbi shërbimin civil, i cili ligj nuk e rregullon strukturën organizative të sistemit prokurorial lidhur me stafin administrativ, për të kaluar pastaj tek trajnimi i stafit administrative që nuk bën pjesë tek ristrukturimi i stafit.

Paneli Vlerësues pyet kandidatin nëse ka ndonjë rast në jetën personale apo profesionale që ia cenon integritetin lidhur me punën si prokuror. Paneli vlerësues fare nuk e sfidon kandidatin edhe përkundër faktit se në publik së paku janë disa raste ku në publik është kontestuar integriteti i kandidatit, si rasti që lidhet me emrin e Morena Taraku, rasti i mbylljes së dosjes së Kryeprokurorit Lumezi, ngritja e shpejtë në karrierë, rasti Sebahate Morinës etj. Paneli vlerësues dhe kandidati kanë privuar publikun nga e drejta për tu informuar lidhur me integritetin e kandidatit lidhur me këto çështje, edhe përkundër se transparenca dhe llogaridhënia ndaj qytetarëve dhe publikut ishin pjesë e konceptit dokumentit dhe intervistës së kandidatit.

Kandidatit i bëhet pyetja lidhur me atë se çka e dallon udhëheqësin nga menaxheri, pyetje e cila i bëhet vetëm këtij kandidati dhe jo tjerëve. Kandidati, nuk ka përgjigje dhe nuk e kupton dallimin në mes menaxherit dhe udhëheqësit.

Në pyetjen e panelit vlerësues për të treguar një rast konkret të rëndësisë së veçantë i cili ka përfunduar më vendim të formës së prerë dhe i cili mund të shërbej si rast shembull për sistemin prokurorial, kandidati merr shembull një rast i cili ende nuk ka marr formën e prerë dhe i cili sipas ankesës është kthyer në ri vendosje. Kandidati nga një rast të rëndësisë së veçantë në fund këtë rast e kthen në “rast interesant”.

Paneli vlerësues bën pyetjen kur mund të kufizohen dhe të suspendohen të drejtat dhe liritë e njeriut, cilat janë ato situata, në të cilat mund të vihet deri te kufizimi i këtyre të drejtave të njeriut. Kandidati nuk ka njohuri lidhur me këtë fushë, dhe nuk ka përgjigje adekuate për këtë pyetje.

v. Lulzim Sylejmani

1. Koncept dokumenti

a) Analiza e gjendjes aktuale

Në koncept dokument, Sulejmani nuk e jep një pasqyrë të qartë rreth gjendjes aktuale në sistemin prokurorial, për më tepër në këtë pjesë ky flet më shumë rreth rolit të institucionit të Prokurorit të Shtetit dhe ngecjen e tij, por nuk jep asnjë detaj se cilat janë aktualisht të arriturat, mangësitë, sfidat dhe vizioni i tij në krye të PSH-së.

b) Vizioni për të përmirësuar punën e Prokurorisë

Sa i përket kësaj pjese, konsiderojmë se pjesën më të madhe të vizionit për përmirësimin e punës së PSH-së, këtë e bazon në ndryshimet ligjore, por jo edhe në veprimet konkrete që janë kompetencë e KPSH-së. Po ashtu, pa dhënë arsye të mjaftueshme, si vizion e sheh edhe rritjen e numrit të prokurorëve, duke mos i paraprirë ndonjë analizë e mirëfilltë rreth gjendjes aktuale të sistemit prokurorial.

c) Vizioni për të menaxhuar stafin dhe sistemin prokurorial

Në këtë pjesë, Sulejmani nuk arrin të theksoi në mënyrë të saktë dhe konkrete çështjen e menaxhimit të stafit dhe sistemit prokurorial, e në koncept dokument shpeshherë i ngatërron kompetencat që i ka KPSH në raport me stafin administrativ të prokurorive.

d) Vizioni për të përmirësuar integritetin dhe llogaridhënien e sistemit dhe besueshmërinë e publikut

Lidhur me këtë çështje, Sulejmani si pikë të vetme thekson çështjen e krijimit të një paneli të përhershëm për trajtimin e rasteve disiplinore në kuadër të KPK-së, e më pas thirret në forcimin e mëtejshëm të mekanizmave aktual. Kësisoj, bie në kundërshtim me atë që e ka paraqitur si vizion të tij në krye të PSH-së.

e) Intervista

Në procesin e intervistimit, Sulejmani nuk ka arritur që në mënyrë adekuate të përgjigjet në pyetjet e anëtarëve të Panelit Vlerësues. Kësisoj, i njëjti nuk përmend asnjë motiv tjetër për pozitën e KPSH-së përveç përvojës së tij në sistem, nuk jep një pasqyrim të qartë lidhur me gjendjen aktuale në sistemin prokurorial, thekson vetëm një mangësi të sistemit (ngritjen e aktakuzave pa prova të mjaftueshme), ngatërron konceptin në mes misionit dhe vizionit të KPSH-së, është i mangët në përgjigjen rreth kufizimit të të drejtave të njeriut dhe në pjesën e familjarizimit me legjislacionin aktual të sistemit prokurorial.

VII. Vlerësimi i panelit vlerësues

Koalicioni në asnjë formë nuk pajtohet me vlerësimin e bërë nga ana e Panelit Vlerësues. Koalicioni e ka parasysh pavarësinë dhe të drejtën e Panelit Vlerësues në bindje të lirë dhe diskrecion për vlerësimin e kandidatëve. Sidoqoftë, bazuar në monitorimin dhe vlerësimin që koalicioni i ka bërë këtij procesi, vlerësimi prej 74 e deri në 98 pikë i kandidatëve, nga maksimumi prej 100 pikëve, është qartazi i pabazuar në një vlerësim objektiv dhe nuk siguron meritokraci në vlerësim.

VIII. Trajtimi i pabarabartë i kandidatëve

Koalicioni gjatë monitorimit dhe vlerësimit të procesit ka vërejtur se jo të gjithë kandidatët janë trajtuar në mënyrë të barabartë, ku për disa kandidatë Paneli Vlerësues ka pasur një qasje të privilegjuar e cila qartazi është vërejtur në publik.

Paneli intervistues nuk ka ndërtuar një intervistë të strukturuar. Kjo më së miri vërehet që disa nga kandidatët pyeten me pyetje shtesë, për dallim nga kandidatët e tjerë. Sikurse, ka pasur pyetje të cilat i janë parashtruar vetëm një kandidati dhe jo edhe kandidatëve të tjerë. Për disa kandidat, i tërë procesi i intervistimit është zhvilluar vetëm në raport me Koncept Dokumentin e dorëzuar, por jo edhe duke bërë pyetje të cilat vërtetojnë zotësitë dhe shkathtësitë e kërkuara, si pjesë e intervistës.

IX. Vlerësimi i integritetit të kandidatëve

Lidhur me integritetin e kandidatëve, paneli vlerësues ka parashtruar pyetje të përgjithshme për secilin kandidat, duke e lënë në diskrecionin e kandidatit për të vlerësuar rastet të cilat ai konsideron se çënojnë integritetin e tij. Nga të gjithë kandidatët, vetëm kandidatit z. Armend Hamiti i bëhen dy (2) nënpyetje shtesë lidhur me rastin e publikuar nga mediat, dy (2) ditë para intervistës.

Në rastin e z. Isufaj, Paneli Vlerësues nuk bënë asnjë nënpyetje lidhur me mbylljen e rastit për deklaram të rremë të pasurisë të parashtruar nga AKK, një trajtim ndryshe nga z. Armend Hamiti i cili sfidohet me dy (2) nënpyetje për një rast të raportuar në media. Po ashtu, z. Isufaj nuk pyetet dhe as nuk jep ndonjë sqarim lidhur me opinionin e AKK-së që konstatonte se emërimi në pozitën e kryeprokurorit brenda periudhës prej (2) viteve pas përfundimit të mandatit si anëtar i KPK-së, përbën konflikt të interesit. Përkundër faktit se z. Isufaj gjatë intervistës së tij thotë se në secilin rast kur ka dyshuar për konflikt të interesit këtë e ka raportuar tek eprori, i njëjti nuk pyetet dhe nuk jep sqarime se pse nuk e ka bërë këtë me rastin e emërimit të tij në krye të PSRK-së, sikurse ka vepruar z. Arben Ismajli.

Tutje, Z. Isufaj po ashtu as nuk është pyetur dhe as nuk ka dhënë sqarime lidhur me akuzat publike të ish-prokurorit special Elez Blakaj të bëra ndaj tij për ndërhyrje në rastin e veteranëve. Në rastin e z. Isufaj, ka pasur edhe raste të tjera që kanë dalur në publik të cilat kanë vënë në dyshim integritetin e z. Isufaj, e të cilat raste janë kaluar në heshtje si nga paneli intervistues ashtu edhe nga ana e z. Isufaj.

Në heshtje kanë kaluar edhe shumë raste të cilat në publik kanë vënë në dyshim integritetin e kandidatit Kujtim Munishi. Raste të kësaj natyre janë rasti i “Bentley të Morena Tarakut”, rastin e dhunë në familje ku ka mbetur e vdekur Sebahate Morina, e që Institucioni i Avokatit të Popullit dhe disa OJQ kanë konsideruar se Prokuroria Themelore në Prishtinë tani të ndjerës Sebahate Morina ia ka shkelur të drejtën në jetë.

Lidhur me këtë Koalicioni vlerëson se pjesa e intervistës lidhur me integritetin ka qenë mundësi adekuate si për kandidatët, panelin vlerësues por edhe për publikun për të marrë sqarimet e duhura nga kandidatët mbi dyshimet e ngritura në publik.

X. Rekomandime

Duke marrë parasysh faktet dhe rrethanat e cekura më lartë, koalicioni rekomandon:

- 1) Të anulohet komplet procesi i përzgjedhjes dhe emërimit të Kryeprokurorit të shtetit për shkak të shkeljeve procedurale dhe defekteve të evidentuara nga koalicioni në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të këtij procesi;
- 2) Komision Vlerësues të publikoj vlerësimin me arsyetim mbi poentimin për secilin kandidat;
- 3) KPK të plotësoj dhe ndryshoj Rregullorën për Procesin e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokuroreëve, me theks të veçantë formularin e koncept dokumentit;
- 4) Të shpallet konkursi i ri duke vazhduar me praktikën e njëjtë të transparencës për sa i përket publikimit të koncept dokumenteve dhe procesit të intervistimit;
- 5) Pyetjet në koncept dokument të orientohen më shumë rreth pozitës së Kryeprokurorit dhe formulohen në atë mënyrë që vlerësojnë shkathtësitë dhe aftësitë se sa njohuritë e përgjithshme;
- 6) Intervista të jetë e strukturuar dhe ky nivel të ruhet gjatë gjithë procesit dhe me të gjithë kandidatët;
- 7) Tek elementi siç është vlerësimi i integritetit, paneli vlerësues sipas detyrës zyrtare duhet të hulumtoj të kaluarën e secilit kandidat pastaj duke paraqitur pyetje të njëjta për secilin kandidat të vlerësoj një cilësi të tillë pyetjet të bëhen në atë formë.